# Votojeni Josefin - mikun e sinqertë të shqiptarëve!

Kontribuar nga Murat
Sunday. 31 May 2009
Azhornuar së fundi Saturday. 13 June 2009

Me 7 qërshor në tërë Suedinë do mbahen zqjedhje për Parlamentin Europian. Sipas rregullave dhe madhësisë së popullësisë së çdo shteti anëtarë të Bashkimit Europian (BE), Suedisë i takojnë 18 vende në PE. Për këto vende konkurojnë të gjitha partitë parlamentare si dhe ato jo-parlamentare. Si zakonisht numërin më të madh të parlamentarëve europian pritet ta marrin dy partitë kryesore në Suedi, Partia socialdemokrate dhe Partia moderate.

Risi në këto zqjedhje është së për 18 vendet në PE konkurojnë edhe një numër i konsiderueshëm politikanesh e veprimtaresh me prejardhjë të huaj. Një prej tyre është edhe Josef Erdem, kurd me prejardhje nga Turqia.  Ai është në listen e Partise socialdemokrate dhe ka numërin rendor 22.

Josefi është një veprimtar i dalluar dhe i palodhur për çështjen e emigrantëve në Suedi. Ai është edhe luftëtar i madh i demokracisë por edhe i çeshtjës së pazqjidhur kurde.

Josefi ka ndihmër luften titanike të popullit të Kosovës për liri e pavarësi. Në çdo forum, instancë politike a institucion vendimmarrës ka propaganduar për Kosovën dhe shqiptarët.

Shqiptarët që jetojnë e gravitojnë më Dalarna e njohin mire konributin e tij për çështjen e Kosovës por edhe të mërgimtarëve në përqjithësi.

Kam bindjen e plotë se Josefi do dij të na përfaqësoi në mënyrën më të mirë dhe më të dinjitetëshme edhe në PE.

Votojeni Josefin më 7 qershor!

Murat Koci

FÖR ETT

RÄTTVIST

EUROPA  tryggare jobbklimatförändringenkollektiva avtaljämställdhetfyktingspolitikarbetslöshetminoritetsrättigheter